



C.nr.679/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu dhe bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani Ismaili, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr."Lidhja e Pejës" p.n. magj. Prishtinë – Fushë Kosovë, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED] nga Prishtina, kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokat nga Ferizaj, për rimbursim dëmi, në seancën e mbajtur me datën 19.12.2018 merr këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, t'ia paguaj shumën prej **1,427.00 €** (njëmijë e katërqind e njëzetë e shtatë euro) në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 14.05.2014, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në banka afariste për një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej 414.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

III. OBLIGOHET paditësja që përfaqësuesit të përkohshëm [REDACTED] avokat nga Ferizaj, t'ia paguaj shumën prej 374.00 € në emër të përfaqësimit, menjëherë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Arsyetimi

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit BSK, me datë 11.08.2017 ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar nga i padituri [REDACTED], t'a rimbursojë shumën prej 799.00 € për shkak të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 14.05.2014, ku në momentin e shkaktimit të aksidentit, i padituri ishte duke vozitur pa mbulesë siguroese, gjegjësisht me afat të skaduar të mbulesës siguroese, nga i cili aksident, ka pësuar dëme materiale në automjetin e tij, i dëmtuari [REDACTED]

Paditësja poashtu me datën 13.09.2017 ka paraqitur padi ndaj të njejtit të paditur, [REDACTED], për rimbursimin e shumës prej 628.00 €, për shkak të aksidentit të njejtë, të datës 14.05.2014, nga i cili aksident ka pësuar dëmtime materiale në automjetin e tij i dëmtuari i dytë [REDACTED]

Paditësja me parashtrësën e datës 21.05.2018, i ka propozuar gjykatës të bëjë bashkimin e lëndëve civile C.nr.679/17 dhe lëndës C.nr.808/17, të cilat përmbajnë palët e njejta dhe kontestin e njejtë. Gjykata, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, me aktvendimin C.nr.679/17 të dt.29.05.2017, ka vendosur që të bëjë bashkimin e lëndëve, ku tani e tutje procedura zhvillohet sipas numrit të lëndës **C.nr.679/17**.

Me që të paditurit nuk i dihej vendbanimi aktual, përfaqësuesja e autorizuar e paditëses në seancën përgatitore ka propozuar që të paditurit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm. Në këtë rast, Gjykata pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore, e ka aprovuar kërkesën e tillë dhe me aktvendimin C.nr.679/17 të datës 23.07.2018, të paditurit i'a ka caktuar si përfaqësues të përkohshëm avokatin [REDAKTUAR] nga Ferizaj.

Gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e autorizuar e paditëses ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për rimbursim dëmi, sepse i padituri me datën 14.05.2014, ka shkaktuar aksident komunikacioni, nga i cili aksident, kanë pësuar dëme materiale në automjetet e tyre [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Paditësja, në bazë të Ligjit për Autopërgjegjësinë, të dëmtuarit të parë [REDAKTUAR] i'a ka kompensuar dëmin në shumë prej 799 euro, ndërsa të dëmtuarit të dytë i'a ka kompensuar dëmin në shumë prej 628 euro, dhe tani bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë që të njejtën shumë ta rimbursojë nga shkaktuesi i aksidentit - i padituri. Andaj, i propozoj Gjykatës që aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurin që të rimbursoj shumat e cekura si në padi, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në banka afariste për një vit pa destinim të caktuar, si dhe shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore dhe për tarifën e përfaqësuesit të përkohshëm, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, në përgjigjen e tij në padi ka theksuar se paditësja duhet të specifikojë në padi se sa është lartësia e kërkesave për dëmin material, jo-material dhe shpenzimet e procedurës sepse paditësi në kërkesëpadi e ka kërkuar vetëm shumën e përgjithshme prej 799 euro. Poashtu paditësja ka kërkuar rimbursimin e shumave si në kërkesëpadi duke ofruar si provë vetëm urdhërin për transfer bankar, e që për mua si përfaqësues i përkohshëm është e pamjaftueshme, ngase provë e mjaftueshme mund të jetë vetëm prova me të cilën vërtetohet arritja e të hollave në llogarinë bankare të kreditorit.

Gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndrojmë pranë thënieve si në përgjigje në padi dhe theksimeve nga seancat e kaluara për të dy lëndët, e njëherit i kërkoj shpenzimet për përfaqësim në dy seanca dhe për përpilim të përgjigjes në padi, sipas TOA.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijon: *urdhërtransferin me nr.FK 1488/14 të dt.05.12.2014; ujdinë jashtëgjyqësore me nr.FK 1488/14 të dt.05.12.2014; vendimin për kompensimin e dëmit të shkallës së dytë me nr.FK 1488/14 i dt.24.11.2014 për të dëmtuarin e parë [REDAKTUAR]*

shkresat e komisionit të shkallës së dytë e dt.24.11.2014; ankesën kundër vendimit të komisionit për trajtimin e dëmeve me nr.FK 1488/14 e dt.31.10.2014; vlerësimin e dëmit të komisionit të shkallës së parë me nr.FK 1488/14 i dt.31.10.2014; kërkesën për kompensimin e dëmit jo-material e dt.16.10.2014; raportin e policisë me nr. 2014CF – 1035 i dt.14.08.2014; raportin e QE Ferizaj nr.1344 i dt.14.05.2014; raportet specialistike nga Poliklinika "Zeka" të dt.28.05.2014 dhe 09.06.2014; raportin specialistik nga Ordinanca "Plus" me nr.890 i dt.06.10.2014; vendimin e Komisionit të shkallës së parë me nr.FK 1488/14 i dt.31.10.2014; transferin bankar i dt.31.12.2014; urdhër transferin me nr.FK 1489/14 i dt.12.12.2014; ujdinë jashtëgjyqësore me nr.FK1489/14 e dt.12.12.2014; vendimin mbi kompensimin e dëmit i shkallës së dytë e dt.24.11.2014 për të dëmtuarin [REDAKTUAR] vlerësimin mjekësor nr.1489/14 i dt.23.10.2014; ankesën kundër vendimit të Komisionit me nr.FK 1489/14 e dt.19.11.2014; vendimin e shkallës së parë me nr.FK 1489/14 i dt. 31.10.2014; deklaratën e të dëmtuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e dt.10.11.2014; raportin specialistik nga Poliklinika "Zeka" e dt.11.06.2014, 25.05.2014, 28.06.2014; raportin specialistik nga Ordinanca "Plus" me nr.670, raportin specialistik nga Klinika Kirurgjike "Aloka" i dt.14.05.2014; raportin nga QE Ferizaj me nr.1345 i dt.14.05.2014; raportin nga QE në Prishtinë me nr.16940 i dt.14.05.2014; kërkesën për kompensimin e dëmit jo-material e dt.16.10.2014.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktyri.

Me rastin e leximit të raportit policor, gjykata ka konstatuar se i padituri ka qenë duke vozitur veturën e tipit Mercedes me targa 01-892-CF, ku si rezultat i mospërshtatjes së shpejtësisë, gjendjes dhe kushteve të rrugës, i njejtë ka humbur kontrollin në timon, me ç'rast është përplasur me një lokalë dhe me një veturë, ku lokali ka pësuar dëme materiale, ndërsa personat në veturë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], kanë pësuar dëme materiale në veturë si dhe lëndime trupore të cilat vërtetohen nga raportet mjekësore. Me leximin e transferit bankar, gjykata ka konstatuar se paditësja i ka kompensuar të dëmtuarin për dëmet materiale dhe jo-materiale në shumë prej 799 euro, repsektivisht 628 euro, shuma këto të cilat përkojnë me shumën të cilat i ka kërkuar në padi dhe kërkesëpadi të të dyja lëndëve.

Nga arsyet e lartpërmenduar, gjykata ka vlerësuar se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit ngase është konstatuar se aksidenti është shkaktuar me fajin e tij. Me që i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit ishte duke vozitur pa mbulesë sigurorese, paditësja ka qenë e detyruar fillimisht t'ua kompensonte dëmin e pësuar të dëmtuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe rrjedhimisht, tani i padituri ka detyrimin që këtë shumë t'ia rimbursonte paditëses, në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në lartësi të shumave të kofirmuara nga paditësja në provat e lëndës.

Pretendimi i përfaqësuesit të përkohshëm se paditësja duhet specifikuar shumën për secilin lloj të dëmit të pësuar e jo të kërkojë vetëm shumën e përgjithshme, për Gjykatën ky

pretendim është i pabazuar, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me rimbursim dëmi e jo me kompensim dëmi, ku shuma e cila kërkohet të rimbursohet është qartë e përcaktuar, pra, paditësja kërkon që t'i rimbursohet vetëm ajo shumë të cilën u'a ka paguar të dëmtuarve në llogarinë e tyre bankare, e cila është vërtetuar mjaftueshëm në provat e lëndës.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata konform nenit 143 të LPK-së; neneve 136, 140, 169, 170, 174 dhe 378 të LMD-së; si dhe nenit 18.4 të LSDA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata e ka obliguar fillimisht paditësen që të paguaj tarifën e përfaqësuesit të përkohshëm [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj në shumë të përgjithshme prej 374.00 € dhe atë si në vijim: për dy seanca të mbajtura nga 135.00 € gjithsej 270.00 €, si dhe për përgjigje në padi shumën 104.00 €, konform nenit 450 të LPK-së.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së, ashtu që ka detyruar të paditurin t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 414.00 €, dhe atë si në vijim: për tarifën e përfaqësuesit të përkohshëm shumën prej 374.00 € dhe për taksën gjyqësore shumën 40.00 €.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.679/17, datë 19.12.2018



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana 11.12.2019 20.19

